LIGJ
Nr.7518, datë 9.10.1991

PËR NJË SHTESË NË DEKRETIN NR.7393, DATË 12.6.1990 "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE PËR JASHTË SHTETIT DHE DHËNIEN E VIZAVE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491 datë 29.4.l991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese ", me propozimin e Këshillit te Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në fund të paragrafit të parë, të nenit 17 të dekretit nr.7393, datë 12.6.l990" Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit dhe dhënien e vizave " shtohen këto fjali: "Të huajve, që kryejnë veprimtari afariste, tekniko-shkencore dhe kulturore të autorizuar nga organet kompetente shqiptare, viza u jepet për udhëtime të pakufizuara me afat deri në l vit. Viza me afat deri në 1 vit u jepet edhe përfaqësuesve të shoqatave të huaj të bamirësisë ".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.64, datë 24.10.l991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia